



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Data/Datum/Date:	19.6.2023
Nr.Br.No:	09/79
Për/ Za/To:	Kryetarin e Komunës, z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtoresha, Albana Fazliu
Lënda/ Predmet/Subject:	Raporti gjashtë mujor i punës nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Të nderuar,

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Shtimes është një institucion kyç që kujdeset për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në komunë. Ne jemi përgjegjës për promovimin e kulturës, të rinisë dhe sportit, si dhe organizimin e ngjarjeve të ndryshme nëpër vit.

Gjatë periudhës Janar-Maj në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë zhvilluar shumë aktivitete të cilat janë të elaboruara në vijim.

15 JANARI 2023 - DITA PËRKUJTIMORE E MASAKRËS SË REÇAKUT

Në këtë vit 15 Janari "Dita Përkujtimore e Masakrës së Reçakut" është mbajtur nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës Sh.T.Z Albin Kurti, në përkujtim dhe nderim të kësaj dite në Kompleksin Memorial në Reçak u bënë homazhe dhe është mbajtur Orë Përkujtimore kushtuar 24-Vjetorit të Masakrës së Reçakut. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin përfaqësues të Institucioneve qendrore dhe ato lokale.

Në përkujtim të kësaj dite është mbajtur një aktivitet nga SHBA "Guri i Shtrenjtë" Ecja tradicionale për nder të 24 Vjetorit të Masakrës së Reçakut

Janë bërë homazhe në varrezat e Dëshmorëve në Shtime dhe në Mollopolc (nga Institucionet Lokale dhe Shoqatat e Dalura nga Lufta).

Akademia përkujtimore është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, ku me prezencën e tyre na kanë nderuar krerët e shtetit si dhe Ambasadori William Walker dhe janë mbajtur fjalimet nga :

Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu

Shkëlqesia e Saj, Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës,

Shkëlqesia e Tij, Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës,

Ambasador William Walker, ish kryesues i Misionit Verifikues në Kosovë

Po ashtu pas fjalimeve performoi kori "Siparantum". Në këtë ditë duke filluar nga ora 15:00, në Shtëpinë e Kulturës u shfaq dokumentari për Masakrën e Reçakut, i përgatitur nga RTK.

19 JANAR 2023 - Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu së bashku me pjesëtar të kabinetit ka bërë homazhe dhe ka vendosur lule pranë varrit të Komandantit Ahmet Kaçiku, të Brigadës 161 në Zonën Operative të Nerodimes, në përvjetorin e rënies së tij heroike.

30 JANAR 2023 – A.K.V "Ilirida", pas përfundimit të audicionit të mbajtur më 11 dhe 12 janar dhe përzgjedhjes të talentëve kanë filluar aktivitetet e tyre në Shtëpinë e Kulturës.

11 SHKURT 2023 - Në 24-vjetorin e varrimit, nënkryetari i Komunës së Shtimes, z. Faruk Beqa së bashku me kryesuesin, z. Adnan Ademi, drejtorët dhe disa nga këshilltarët komunal, kujtuan e nderuan me homazhe martirët të rënë në Reçak.

14 SHKURT 2023 - Për nderë të 15 Shkurtit – Ditës së Flamurit të Komunitetit Ashkali, Këshilli Organizativ në Komunën e Shtimes, ka organizuar program kulturor-artistik.

I pranishëm në këtë manifestim ishte nënkryetari i Komunës së Shtimes, z. Faruk Beqa dhe z. Ibrahim Demiri, shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

17 SHKURTI 2023 – 15 VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

17 Shkurti “Dita e Pavarësisë” është shënuar me aktivitete të ndryshme të organizuar në bashkëpunim me klubet sportive, OJQ lokale dhe shkollat.

Më 14. 2. 2023 nga ora 18:00 – është mbajtur Orë letrare, nga poet, profesor dhe shumë krijues të rinjë, (në Shtëpinë e Kulturës) .

Në ora 19:00 – është hapë Ekspozita nga nxënësit e SHML”Naim Frashëri” e cila ka qëndruar e hapur një javë në Shtëpinë e Kulturës.

Më 16 shkurt 2022 duke filluar nga ora 18:00 është mbajtur Program kulturo-artistik nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Shota” (në Shtëpinë e Kulturës);

Më 16 shkurt 2022: Turniri në Futsal (Palestra e Sporteve në Shtime)

Më 17. 2. 2023 – janë zhvilluar disa aktivitete, duke filluar nga Seanca solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes e cila është mbajtur në ora 9:00 në sallën e kuvendit.

Nga ora 9:30 – janë bërë Homazhe të shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, homazhe në varrezat e Dëshmorëve në Shtime, Reçak, Mollopoc, Rancë dhe Carralevë;

Duke filluar nga ora 14:00 – është mbajtur Programi kulturo-artsistik nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Ilirida” (në Shtëpinë e Kulturës);

Në ora 16:00 – është mbajtur Ceremonia e zgjedhjes së sportistëve të vitit 2022 (në Shtëpinë e Kulturës) dhe në ora 19:00 – është luajtur Finalja në futboll të vogël e turnirit “Pavarësia” (në fushën “Arbëri” në fshatin Reçak).

Në garën e organizuar për nderë të ditës së Pavarësisë nga Klubi i Çiklizmit Vjosa Shtime në kuadër të kalendarit të garave të Federatës së Çiklizmit mori pjesë edhe Klubi i Çiklizmit Dardana. Prezent ishte Kryetari i Federatës z. Avni Nuha, si dhe Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës z. Ismet Krasniqi.

ZGJEDHJA E SPORTISTËVE PËR VITIN 2022

Në ceremoninë e mbajtur më 17.02.2023, janë zgjedhur më të mirët për vitin 2022, sportist, trenera, puntor sportiv etj, të cilët janë shpërblyer me mirënjohje, plaketa e kupa.

Veterani i sportit në Komunën e Shtimes është zgjedh ish hendbollisti, referi dhe treneri i KHF “Vjosa” z. Shaqir Shaqiri

Me mirënjohje Post Mortum janë nderu Behare Brahaj Ismajli, Nysret Musliu dhe Ahmet Hysenaj sportistat të cilët kanë kontribuar për sportin shtimjan, por për fat të keq nuk gjenden në mesin tonë.

Xhevdet Smajli është shpërbly me mirënjohje dhe plaketë për sportistin e veçant për rezultatet e arritura në garat e karates, në kategorinë parakarate.

Klubi më i mirë për vitin 2022 është zgjedhur Klubi i Futsallit “Vjosa”, i cili gjatë viti 2022 ka arrit që të kalojë nga liga e parë në Superligën e Kosovës në Futsall.

Treneri më i mirë për vitin 2022 është zgjedhur Nesret Salihaj nga Klubi i Kik-Boksit “Skender Salihaj”

Referi më i mirë për vitin 2022 është zgjedhur Ardian Rushiti.

Puntori Sportiv është zgjedhur Avdi Sadiku nga KF”Vjosa” i cili me angazhimin e tij ka arrit që të organizoj klubin në mënyrën më të mirë, të ofroj donator për klubin dhe të sjell rezultate dhe suksese me klub duke kaluar nga liga e dytë në ligën e parë të futbollit.

Dhe sponzori më i mirë për vitin 2022 është zgjedhur Besimi Comerc”

Janë shpërblyer edhe më te dalluarit ne kategorinë pioner per vitin 2022,

Sara Ramadani nga Klubi I Volejbollit Femrat,
Albion Veliu nga Klubi I Karates “Vjosa”
Redon Bajrami nga Klubi I Futbollit “Vjosa”
Denisa Rexhepi nga Klubi I Hendbollit “Vjosa”
Ervin Shaqirin nga Klubi I Hendbollit “Vjosa”

Janë shpërblyer me mirënjohje edhe më të dalluarit per vitin 2022 në kategorin Junior:

Dalmat Salihaj nga Klubi I Kik-Boksit “Skender Salihaj”
Butrint Ahmeti nga Klubi I Futbollit “Vjosa”
Pashtrik Krasniqi nga klubi I Çiklizmit “Vjosa”
Erinda Veliu nga Klubi I Boksit “Skender Salihaj”
Erza Osmani nga Klubi I Karates “Vjosa”

Janë shpërblyer me kupa dhe mirënjohje sportistët më të dalluar pë vitin 2022 dhe sportisti i vitit:

Alma Bislimi nga Klubi Motocross “Vjosa”
Enes Haxha nga Klubi I Volejbollit “Vjosa” meshkujt
Erblin Qerimi nga Klubi Hendbollit “Vjosa” meshkujt
Shkelqim Roshaj nga Klubi Motocross “Vjosa”
Arjeta Maliqi nga Klubi Hendbollit “Vjosa” femrat
Mexhide Tershani nga Klubi I Volejbollit “Vjosa” femrat,
Qendrim Abazi nga klubi I Çiklizmit “Vjosa”
Përparim Livoreka nga Klubi I Futbollit “Vjosa”
Arber Salihaj nga Klubi I Kik-Boksit “Skender Salihaj”

Dhe sportisti i vitit 2022 është zgjedhur Jetmir Gashi nga Klubi i Futsallit “Vjosa”

ËSHTË SHËNUAR 25-VJETORI I EPOPESE SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

6 MARS 2023 – Me rastin e shënimit të 25-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, së bashku me nënkryetarin e komunës, Faruk Beqa, kryesuesin e Kuvendit, Adnan Ademi, drejtorë e zyrtarë komunalë, veteranë e invalidë të UÇK-së, pjestarë të FSK-së si dhe qytetarë tjerë, kanë bërë homazhe pranë shtatores së Komondantit Legjendar Adem Jashari në qendër të Shtimes, pastaj te Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Shtime, në Kompleksin Memorial në Reçak dhe te Varrezat e Dëshmorëve në Mollopolc.

Në shenjë nderimi për luftën dhe sakrificën e tyre për liri, gjatë ditës ky delagacion ka bërë homazhe edhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

7 MARS 2023– në ora 8:30 është mbajtur mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes, kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në ora 18:00, për nder të Epopesë së UÇK-së mbi fshatin Reçak, te Kulla e Lirisë është bërë ndezja e Flakadanëve për Zonën Operative të Nerodimes në komunën e Shtimes.

16 MARS 2023 – Komedia “Kërkohet bashkëshort i ri”, me regji të Gëzim Hasanit dhe autor Miro Gavranit, mbrëmë u shfaq para publikut shtimjanë, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime.

Shfaqja ishte përgatitur jashtëzakonisht mirë nga aktorët: Brahim Basha, Arbnorë Nuha dhe Butrint Lumi.

21 MARS 2023 – Grupi Letrar “Dita” ka mbajtur mbrëmjen poetike me moton: “Me poezinë dhe për poezinë”. Ky aktivitet kulturor është realizuar së bashku me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, me rastin e 21 Marsit – Ditës Botërore të Poezisë.

Në këtë ngjarje kulturore, i pranishëm ishte nënkryetari i Komunës, Faruk Beqa dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Albana Fazliu, e cila përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti kushtuar Ditës Botërore të Poezisë. Hapjen e mbrëmjes poetike e bëri, drejtori i AKV “Dita”, Abdyl Hajredini, i cili foli për rëndësinë e poezisë, njëherit recitoi edhe tri poezi të zgjedhura nga krijimtaria e tij. Këtë mbrëmje me poezitë e tyre e pasuruan edhe poetët tjerë: Rexhep Hasani, Zymrije Salihu, Besim Arifi, Sevdî Qorrolli, Shkëndije Qeriqi dhe Imri Musliu

19 PRILL 2023 – Grupi Letrar i AKV “Dita” organizon ore letrare “Katërkendeshi poetik” ku ne kete ore letrare moren pjese poete nga Suhareka, Skënderaj, Ferizaj dhe Shtime ku krahas leximit te poezive nga autoret kishte edhe debat me temen “Poezia sot”.

25 PRILL 2023 - Orë letrare kushtuar Ditës së Librit, nën shoqërimin e drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, Albana Fazliu dhe mysafires Teuta Elshani, në Shkollën e Mesme të Ulët “Emin Duraku” në Shtime është mbajtur një orë letrare, ku janë recituar poezi dhe është diskutuar rreth poezisë. Kjo ditë është shënuar me rastin e 23 Prillit – Ditës Botërore të Librit, ku krahas të pranishmëve tjerë, kishte edhe mësimdhënës të shkollës së lartpërmendur.

Fillimisht, fjalën mori drejtori i shkollës “Emin Duraku”, Rexhep Hasani, i cili ka përshëndetur të pranishmit duke potencuar se çmon çdo takim që për temë ka artin dhe fjalën e burkur.

Më pas fjalën mori, Teuta Elshani e cila në mënyrë të përmbledhur foli për librat e atutorit Ymer Elshani, i cili tashmë pos epitetit shkrimtar për fëmijë ka edhe epitetin heroit, pasi që autori është vrarë gjatë luftës nga forcat barbare serbe. Titujt e librave që u sollën në shkollë janë:

1. Planeti i mirësisë
2. Ndodhitë e hundëkarrotës
3. Kur vallëzojnë buzëqeshjet
4. Kërpudha magjike etj...

Në vazhdim, nxënësit e shkollës me poezitë e tyre të përzgjedhura dhe me recitime mahnitëse i dhanë ngjyrën fjalës së bukur, artit në përgjithësi.

8 MAJ 2023 -Në ora 20:00, nxënësit e shkollës së baletit "Mjellmat", në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, kanë shfaqur premierën "Sanctuary" me koreografi të Nisa Krasniqit.

11 MAJ 2023 – Shfaqja “Tomy and Jerry” u shfaqë në shtëpinë kultures për fëmijët parafillor të komunës së Shtimes në dy termine.(kjo shfaqje është realizuar në bashkëpunim me edukatorët dhe këshillin e prindërve, hyrja ka qenë 1.00 € për fëmijë ku pjesën tjetër e ka mbuluar DKRS)

1 QERSHOR 2023- Në Shtëpinë e Kulturës për nxënësit e klasave: I, II dhe III është shfaqur filmi “Balonat për fëmijët”, mandej për nxënësit e klasave: VI dhe V është mbajtur ligjërata nga Policia e Kosovës me temën: “Siguria në rrugë”. Gjithashtu për nder të kësaj dite ekipi i futbollit “Vjosa” për nxënësit e klasave: IV dhe V ka organizuar lojën “Parafatos” dhe “Babina”.

12 QERSHOR- Në kuadër të kësaj dite, më 11.6.2023 në Palestrën e Qytetit nga Klubi i Kik-Boksit “Skender Salihaj” në bashkëpunim me Federatën e Kik-Boksit të Kosovës është organizuar turniri “Shtimja Open”, ku morën pjesë klube nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Më pas kanë vazhduar aktivitetet sportive në Stadiumin e Qytetit me lojën e vajzave në futboll ndërmjet KfV “Prishtina” nga Prishtina dhe KfV “Prishtina” nga Shtimja.

Ndërkaq, për dashamirët e artit skenik, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime është dhënë shfaqja teatrale “Shkamat” me regji të prof. Fadil Hysajt, e luajtur nga trupa e aktorëve profesional: Bislim Muçaj, Sheqerie Buçaj dhe Butrint Lumi.

12.6.2023 -Me rastin e 24-Vjetorit të çlirimit të komunës së Shtimes,me kanë vazhduar aktivitetet për shënimin e kësaj dite të rëndësishme historike duke filluar me mbajtjen seancës solemne të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

Për të nderuar dhe kthyer kujtesën në këtë ditë që shënoi fillimin e një epoke të re për liri, kryetari i Shtimes, Qemjal Aliu së bashku me bashkëpunëtorë, përfaqësues e anëtarë të shoqatave të dala nga lufta, familjarë të Dëshmorëve të Kombit, këshilltarë komunalë dhe qytetarë të shumtë janë përkulur para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari duke vendosur buqeta me lule. Në nderim të gjakut të derdhur për liri ka vazhduar ceremonia e homazheve dhe vendosjes së kurorave me lule, te Sheshi i Dëshmorëve në Shtime, në Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Shtime, Mollopolc, Reçak, Rancë dhe Carralevë.

Po ashtu gjatë kësaj dite është zhvilluar ndeshja miqësore në futboll të madh nga Klubi i Veteranëve të Futbollit me Ekipen e Komunës.

Me një program të pasur kulturo-artistik, Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Ilirida" në bashkëpunim me DKRS-ën ka shënuar Ditën e Çlirimit të Komunës së Shtimes. Po ashtu, në mbrëmje para publikut shtimjanë kanë performuar edhe Hysni Klinaku dhe Diellza Zenuni.

Sport

Të gjitha klubet sportive kanë përfunduar garat e sezonit pranveror dhe kanë arritur rezultate të kënaqshme:

Klubi i Futbollit "Vjosa" garon në Ligë e Parë të Futbollit në Republikën e Kosovës dhe janë në vendin _____ në tabelë.

Klubi i Futsallit "Vjosa" garon në Superligën e Kosovës në Futsall, kanë përfunduar garat e sezonit pranveror dhe janë në vendin e dytë në tabelë.

Klubi i Hendbollit "Vjosa" femrat – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe radhiten në vendin e tretë në ligën e parë të hendbollit të Kosovës, ndërsa vazhdojnë garat me grupmoshat e pioniereve.

Klubi i Hendbollit "Vjosa" meshkujt – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe radhiten në vendin e _____ në tabelë.

Klubi i Volejbollit "Vjosa" femrat – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës dhe radhiten në vendin e dytë në tabelë.

Klubi i Volejbollit "Vjosa" meshkujt – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës dhe radhiten në vendin e katërt në tabelë.

Klubi i Veteranëve të Futbollit "Vjosa" – kanë përfunduar garat në Ligën e Veteranëve në Futboll.

Klubi i Çiklizmit "Vjosa" – kanë përfunduar garat në çiklizëm në kuadër të kalendarit të Federatës së Çiklizmit të Kosovës.

Klubi i Motocrossit "Vjosa" – kanë realizuar garat në kuadër të Federatës të Motocrossit në Kosovës, ku garuesi Halit Rexhaj do të marr pjesë në garën më të madhe në Austri.

Klubi i Kik-Boksit "Skender Salihaj" – kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Federatës së Kik-Boksit të Kosovës, kanë marr pjesë në turne të ndryshme kombëtarë dhe ndërkombëtare.

Klubi i Kik-Boksit "Skender Salihaj" – kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Federatës së Boksit të Kosovës, kanë marr pjesë në turne të ndryshme kombëtarë dhe ndërkombëtare, ku me date 18-21 Maj do të përfaqësojnë Kosovën në garat botërore në Turki.

Klubi i Karatesë "Vjosa" – kanë zhvilluar garat në kuadër të Federatës së Karatesë të Kosovës.

SHBA "Guri i Shtrejtë" – ka zhvilluar disa aktivitete të bjeshkatarisë.

SH.P.S.R "Shoqata e peshkatarëve sportiv rekreativ SALMONI" – këtë vit ka mbajtur gara komunale Peshkim me Tapë- Batllava 2023, ku në këtë garë morën pjesë të gjitha grupmoshat, veteran, senior, junior, pioner dhe vajza.

SUBVENCIONET

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë këtij viti ka bërë tri thirrje publike për përkrahje financiare për OJQ-të rinore, kulturore dhe klubet sportive.

Thirrja për sport ka vlerën prej 44000€ dhe ka përfunduar, kemi pas 16 kërkesa nga klubet sportive të cilat janë shqyrtuar nga komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve.

Thirrja për Kulturë ka vlerën prej 6750€ dhe është e hapur nga data 23.6.2023

Thirrja për Rini ka vlerën prej 7000€ dhe është e hapur nga data 23.6.2023

INVESTIMET KAPITALE

Projektet kapitale që janë të planifikuara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023 e që kanë përfunduar me procedurat e prokurimit dhe që janë lidhur kontratat, dhe priten të fillojnë punimet shumë shpejt sipas planit të menaxhimit janë:

Projekti për Zërimin dhe Ndriçimin Profesional në Shtëpinë e Kulturës projekt dy vjeçar në vlerë prej 25,000.00€, ku kontrata ka vlerën 24,292.00 €

Projekti për blerjen e gjeneratorit për palestren e sportit i cili ka qenë i planifikuar me vlerë prej 10,000.00€, kontrata është lidhur në vlerë 9,875.00€

Projekti i Rrethojave dhe Ndriçimit publik i fushave në Petrovë, Vojnoc dhe Gllavicë ka përfunduar, projekt i cili ka qenë dy vjeçar dhe ka pas vlerën 18.751.53 €

Projektet për furnizime disa janë ende në procedurë të prokurimit dhe disa kanë përfunduar dhe janë lidhur kontratat si: **Furnizimi me buqeta me lule** e cila ka vlerën prej 1288.00€

Furnizimi me material hixhienik nga DKRS kemi vlerën prej 1000.00€

Projekti për manifestimin e Festave Shtetërore dhe Komunale është duke u zhvilluar dhe ka vlerën 14,288.00, ku janë të përfshira të gjitha festat për vitin 2023

Projekti i Hapsirave të Shtëpia e Kulturës, Palestra e Sportit dhe Muzeu, projekt dy vjeçar i cili në muajin gusht 2023 përfundon dhe 90% e punimeve kanë përfunduar, dhe vlera e projektit është 27,063.50€.

— OVER —

Projekti Nërtimi i fushës sportive në fshatin Zborc, është duke u hartuar nga zyra projektuese dhe ka vlerën 10,000.00€

Ndërsa projekti për renovimin e Stacionit është dërguar në MKRS, ku vlera për renovimin e stacionit është mbi 2.000.000 (dy milion) €, në këtë projekt do të rregullohen tribunat, zhveshtoret dhe do të ndërrohet bari sintetik, poashtu edhe renovimi i Palestres Sportive, ku në këtë projekt do të rregullohen pjesa administrative, ngrohja furnizimi me pajisjet për të gjitha sportet ku do të krijohet një ambient me i mirë për sportistët, ku edhe këtë projekt do ta përkrah MKRS.

Gjatë periudhës Janar- Qershor, Muzeun e Qytetit e kanë vizituar (180) vizitor ku (115) prej tyre kanë qenë meshkuj dhe (65) prej tyre femra, po ashtu në mënyrë të organizuar kanë vizituar muzeun, gazetarë, student të historisë, nxënës të shkollave të cilët kanë parë përsëafërm reliktet dhe eksponatat që janë në muze dhe kanë mësuar për historinë dhe vlerat e muzeut, pastaj ka pas vizita edhe nga OJQ-ët dhe televizionet e ndryshme, institucionet etj.

Në bibliotekën e qytetit vazhdimisht po rritet numri i lexuesve dhe fondi i librave, numri total i lexuesve gjatë periudhës Janar-Qershor është (1540), lexues aktiv (650), lexues të rinjë janë (30), libra të lexuara janë (980). Edhe në bibliotekën e qytetit kemi donacion prej MKRS-së, ku vlera e librave të dhuruara është 6400 Euro, ku më 18 Maj kemi pranuar 410 tituj të rinj, 914 ekzemplar.

Me respekt,
Nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport